
Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

FORCIMI I EFICENCËS DHE CILËSISË SË SYSTEMIT TË DREJTËSISË NË SHQIPËRI (SEJ III)

Mbledhja e të Dhënave, Menaxhimi i Çështjeve dhe Strategjia e IT-së në Shqipëri

Beqiraj - Epineuse - Stawa

Mars 2020

Indeksi

1. Lista e shkurtimeve.....	4
2. Metodologjia, qëllimi dhe objekti (GEORG)	5
3. Udhëzimet e CEPEJ për Statistikat Gjyqësore (GEORG)	6
3.1. Parimet e përgjithshme	6
o <i>Procedurat dhe mekanizmat</i>	6
o <i>Transparenca dhe përgjegjësia për të dhënat</i>	7
o <i>Vlerësimi i sistemeve gjyqësore evropiane</i>	7
3.2. Parime specifike	8
o <i>Buxhetet e drejtësisë</i>	8
o <i>Burimet njerëzore</i>	8
o <i>Aktiviteti i gjykatave, afatet procedurale dhe vlerësimi i punës</i>	8
o <i>Monitorimi i shkeljeve të Nenit 6 të KEDNj-së</i>	9
4. Konteksti dhe fushat e mbuluara gjatë misionit (JULINDA)	10
4.1. Reforma e gjyqësorit në Shqipëri.....	10
4.2. Kuadri Ligjor Vendas dhe Praktika për statistika gjyqësore në fushat e mbuluara gjatë misionit	11
o <i>Sistemi statistikor</i>	11
o <i>Mbledhja e statistikave</i>	12
o <i>Futja e të dhënave dhe validimi i tyre</i>	12
o <i>Publikimi i të dhënave dhe detyrimet për raportim</i>	12
5. Misioni përgatitor për statistika gjyqësore të sistemit të drejtësisë në Shqipëri nga CEPEJ, janar 2017 (HAROLD)	15
6. Vlerësimi dhe Rekomadnimet e Ekspertëve (TË GJITHË)	18
6.1. Bazat e mbledhjes së të dhënave dhe standardet	18
6.2. Statistikat strategjike.....	19
6.3. Menaxhimi gjyqësor objektiv.....	19
6.4. IT.....	20
6.5. Politika.....	21
6.6 Të ndryshme	21
7. Lista e rekomandimeve.....	23

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

1. Lista e shkurtimeve

CEPEJ	Komisioni Evropian për Eficencën e Drejtësisë
KiE	Këshilli i Evropës
KE	Komisioni Evropian
GJEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
KL Gj	Këshilli i Lartë Gjyqësor
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
MD	Ministria e Drejtësisë
ShM	Shkolla e Magjistraturës
GjL	Gjykata e Lartë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar

2. Metodologjia, qëllimi dhe objekti (GEORG)

Komisioni Evropian i Këshillit të Evropës për Eficencën e Drejtësisë (CEPEJ) po zbaton fazën e tretë të Projektit për “Forcimin e Eficencës dhe Cilësisë së Drejtësisë në Shqipëri” (SEJ III), i cili është pjesë e programit me titull Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë” (HF II), bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Këshilli i Evropës (KIE).

Një prej prioriteteve kryesore të SEJ III është që të ndihmojë Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGj) për të zbatuar kuadrin e ri legjislativ sipas standardeve dhe mjeteve të CEPEJ. KLGj-ja do të donte të mbështetej kryesisht tek CEPEJ në hartimin e rregulloreve specifike për zbatimin e ligjeve të reja. Prioritetet e tyre aktuale përfshijnë hartimin e rregulloreve të brendshme të gjykatave për eficencën dhe cilësinë; statistikave gjyqësore dhe menaxhimi i çështjeve (të cilat do të përfshijnë edhe një Strategji të IT-së në të ardhmen), si dhe zbatimin e skemës së re për vlerësimin e gjyqtarëve.

Në këtë kuadër, një ekip ekspertësh ndërkombëtarë të CEPEJ (Julinda Beqiraj, Harold Epineuse dhe Georg Stawa) të mbështetur nga ekipi lokal i CEPEJ/SEJ, kryen një vlerësim të situatës aktuale dhe të problemeve që lidhen me mbledhjen e statistikave gjyqësore me qëllim ofrimin e rekomandimeve për një qasje më konsistente për mbledhjen e statistikave gjyqësore në përputhje me Udhëzimet e CEPEJ/SATURN dhe me standarde të tjera, të cilat do të duhet të përshtateshin sipas nevojës së Shqipërisë. Në raportin përfundimtar, do të adresohet përgatitja e udhëzimeve për një metodologji të unifikuar për mbledhjen e të dhënave, mbështetjen që do t'i jepet departamentit të KLGj-së për IT/Statistikave, mbështetjen e KLGj-së për përgatitjen e formularëve të gatshëm përkatës, mbështetjen për specifikimin e sistemit të ri IT dhe CMIS, si dhe trajnimi i nëpunësve përkatës të të gjitha niveleve.

Për qëllime të këtij misioni, u organizuan takime dhe seminare specifiku me përfituesit vendas, disa anëtarë të KLGj-së dhe anëtarë të stafit teknik që punon me statistikave gjyqësore, menaxhimin e çështjeve dhe vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, korrespondentët e CEPEJ dhe përfaqësuesit e departamentit të statistikave të Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe përfaqësuesit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (shih agjendën bashkëngjitur).

Përveç kësaj, Ofruesi u takua edhe me partnerët ndërkombëtarë, Projektin e USAID “Drejtësi për të Gjithë” dhe në veçanti me EURALIUS, i cili ka një rol lider në asistimin e KLGj-së sa i përket ngritjes së sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve ICMIS dhe Strategjisë IT, për të cilat janë dhënë kontribute në kuadrin e SEJII dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në mënyrë që të gjitha projektet e tjera të financuara nga BE-ja në mbështetje të KLGj-së të jenë konsistente dhe plotësuese të njëra-tjetrës.

Qëllimi ishte:

- Pjesëmarrja në takime dhe adresimi i çështjeve të “qeverisjes” në këtë fushë dhe promovimi i shembujve të praktikave të mira në të gjitha fushat që lidhen me të, duke përfshirë CMIS, si dhe garantimi i konsistencës dhe koordinimit me Projektin Rajonal të Dashboard-it.



- Dhënia e kontributeve për këtë raport, duke trajtuar fushat e mbuluara gjatë misionit, siç përmenden më sipër.

Ekipi i Ekspertëve u mbështet nga Ekipi i Projektit SEJ III, i cili koordinoi punën e përfaqësuesve të CEPEJ dhe përgatiti të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme, si dhe shënimet shpjeguese.

3. Udhëzimet e CEPEJ për Statistikat Gjyqësore¹ (GEORG)

Si kujtesë për disa nga parimet bazë që duhet të ndiqen, në këtë kontekst mund të përmenden paragrafët kryesorë të Udhëzimeve të CEPEJ për Statistikat Gjyqësore (GOJUST):

3.1. Parimet e përgjithshme

Qëllimi kryesor i statistikave gjyqësore është lehtësimi i funksionimit eficient të sistemit gjyqësor, si dhe kontribuimi në drejtimin e politikave publike të drejtësisë. Për këtë arsye, statistikave gjyqësore duhet t'u japin mundësi politikëbërësve dhe profesionistëve gjyqësorë që të marrin informacione të rëndësishme lidhur me performancën e gjykatave dhe cilësinë e sistemit gjyqësor, konkretisht ngarkesën e punës së gjykatave dhe gjyqtarëve, kohëzgjatjen e nevojshme të trajtimit të kësaj ngarkese, cilësinë e rezultateve të gjykatave dhe sasinë e burimeve njerëzore dhe financiare që duhet t'i vihen në dispozicion sistemit për përbalimin e fluksit të punës.

Të gjitha të dhënat për performancën dhe cilësinë e sistemit gjyqësor duhet të mblidhen dhe të paraqiten përmes një metodologjie të përshtatshme dhe konsistente që mund të aplikohet nga të gjitha degët dhe organet e gjyqësorit, në mënyrë që të krijojë mundësi për vlerësimin e efikasitetit të mjeteve që u janë vënë në dispozicion.

Çdo vend anëtar duhet të marrë masa specifike institucionale statistikore me qëllim që të mbledhë, të koordinojë, të bashkojë dhe të përpunojë informacionet nga ofruesit e ndryshëm të statistikave, të cilat janë të nevojshme për vlerësimin e funksionimit dhe për matjen e aktivitetit të gjykatave, prokurorive, shërbimeve administrative brenda sistemit gjyqësor dhe çdo organi tjetër që ka një rol në aktivitetin gjyqësor.

○ Procedurat dhe mekanizmat

Për ngritjen e një sistemi për mbledhjen dhe shpërndarjen sistematike të informacioneve statistikore duhet të bihet dakord mes aktorëve të ndryshëm për procedurat dhe afatet që duhen të ndiqen. Për adresimin e pyetjeve të përgjithshme, menaxhimin e mirëmbajtjes së sistemit dhe zgjidhjen e konflikteve në lidhje me funksionimin e sistemit, si dhe me besueshmërinë dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura duhet të përcaktohen paraprakisht dhe në mënyrë të qartë përgjegjësitë dhe mekanizmat e ndryshëm.

¹ GOJUST, miratuar nga CEPEJ në takimin e 12-të plenar, Strasburg, 10/11 dhjetor 2008.

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

Të dhënat statistikore që janë mbledhur në të kaluarën duhet gjithashtu të përdoren sa më shumë që të jetë e mundur në sistemet e ardhshme për krijimin e serive kohore.

Kur autoritetet kompetente të shpërndajnë burimet mes organeve gjyqësore, duke përdorur të dhënat për situatën bazë përmes statistikave, për garantimin e një sistemi të drejtë dhe transparent, duhet të ngrihet një mekanizëm monitorimi për aplikimin si duhet të rregullohet për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave.

Kërkesat për statistika nuk duhet t'i mbingarkojnë më shumë se duhet punonjësit e gjykatave, por duhet të përkojnë me nevojat për një menaxhim sa më të mirë të të gjithë sistemit gjyqësor.

Ngritja e një sistemi IT për t'u përdorur për qëllime statistikore duhet që ta bëjë më të shkurtër ciklin e dorëzimit dhe përpunimit të të dhënave gjyqësore.

○ **Transparenca dhe përgjegjësia për të dhënat**

Përgjegjësinë për të dhënat e garanton profesionalizmi dhe etika e personave, të cilëve u besohet përpunimi i të dhënave dhe pavarësia e tyre përkundrejt organeve të tjera politike ose administrative, si dhe organeve të tjera private. Shtetet duhet të marrin masa që këta persona të kenë aftësitë e duhura dhe duhet të garantojë nivelin e nevojshëm të pavarësisë, në mënyrë që të realizohet një punë shkencore e përgjegjshme dhe e një cilësie të lartë.

Të gjitha mbledhjet dhe analizimet e të dhënave duhet të ndërmerren në mënyrë transparente. Rezultatet kryesore jo vetëm që duhet t'u paraqiten të gjithë aktorëve të drejtpërdrejtë të administrimit të drejtësisë, por edhe të gjithë personave të përfshirë në funksionimin e sistemit gjyqësor. Për përmirësimin e këtij mekanizmi mund të merren parasysh opinionet e studiuesve.

Të dhënat dhe analizat e tyre nuk duhet të personalizohen. Ato duhet të paraqiten në mënyrë të tillë që të jenë lehtësisht të kuptueshme me qëllim që të kontribuojnë në transparencën dhe pranimin e të gjithë sistemit nga të gjithë personat e interesuar dhe të garantojnë paanshmëri në informacionet e paraqitura. Formulatat komplekse duhet të shmangen sa më shumë që të jetë e mundur.

Të dhënat e mbledhura në nivel kombëtar duhet të bëhen të ditura publikisht, konkretisht përmes publikimit të tyre në Internet.

Për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave gjyqësore në vendet anëtare duhet të merren hapat e nevojshëm nga organet përgjegjëse për këtë proces për të garantuar dialogun me organizatat që përfaqësojnë profesionet juridike dhe gjyqësore, studiuesit dhe, sipas rastit, me organizatat e interesuara për këto çështje, për të garantuar një konsensus të gjerë për informacionet e mbledhura dhe të komunikuarat.

○ **Vlerësimi i sistemeve gjyqësore evropiane**



Mbledhja e të dhënave duhet të organizohet, duke marrë parasysh sa më shumë Skemën e Vlerësimit të CEPEJ, në mënyrë që përgjigjet të mund të jepen në mënyrë të herëpashershme për pyetjet që përbëjnë pjesë të procesit të vlerësimit të sistemeve gjyqësore evropiane. Vëmendje duhet t'i kushtohet gjithashtu edhe orientimeve të dhëna në Shënimet Shpjeguese, për të garantuar homogjenitetin e koncepteve të marra në konsideratë dhe metodat e matjes të përdorura në to.

Në mënyrë të veçantë, çdo shtet anëtar duhet të marrë masat e nevojshme që do t'i lejonin ofrimin e kontributeve vjetore në trupën e të dhënave kryesore të drejtësisë në Evropë, sipas përkufizimeve të CEPEJ (shih Shtojcën II).

3.2. Parime specifike

○ **Buxhetet e drejtësisë**

Në mënyrë që të vlerësohen përpjekjet e shteteve për zhvillimin e sistemeve të tyre gjyqësore, mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore duhet të organizohen në mënyrë të tillë që të ndahen buxhetet për:

- pagat
- ndihmën juridike
- kompjuterizimin (pajisje, investime dhe mirëmbajtje),
- shpenzime gjyqësore,
- investime në godinat e reja,
- mirëmbajtje godinash, funksionim dhe kosto,
- trajnim dhe edukim i gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Të dhënat gjyqësore duhet të mblidhen dhe të përpunohen sa më shumë që të jetë e mundur në mënyra të tilla që lejojnë dallimin mes buxheteve për funksionimin e gjykatave nga buxhetet për funksionimin e prokurorive. Nëse sistemi gjyqësor organizohet në mënyrë të tillë që nuk e bën të mundur këtë dallim, atëherë duhet të ngrihet një sistem, ku numri i gjyqtarëve dhe numri i prokurorëve të mund të lejojnë peshimin e rezultateve statistikore ose një sistem që mundëson përlllogaritjen e buxheteve të dedikuara sistemit të prokurorisë.

Informacionet statistikore duhet të mbulojnë si buxhetet e miratuara, ashtu edhe ato faktike.

○ **Burimet njerëzore**

Shifrat e personelit gjyqësor (gjyqtarë, prokurorë, nëpunës gjykatash, etj.) duhet të jepen sa më shumë që të jetë e mundur, duke përdorur ekuivalentin me kohë të plotë.

○ **Aktiviteti i gjykatave, afatet procedurale dhe vlerësimi i punës**

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

Sistemi statistikor duhet të krijojë mundësi, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel gjykatash, për vlerësimin e kohëzgjatjes totale të procedimeve sipas një tipologjie të shtjelluar mjaftueshëm të çështjeve.

Një pjesë e mirë e çështjeve para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kanë të bëjnë me shkeljen e “kohës së arsyeshme” të procedimeve, parashikuar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke qenë se është e vështirë të ofrohen zgjidhje efikase për afate optimale dhe të parashikueshme, me përjashtim të rasteve kur kemi paraprakisht një njohje të hollësishme të situatës, vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet informacionit të mbledhur mbi kohëzgjatjen e procedimeve.

Vendet anëtare duhet të jenë veçanërisht në gjendje të ofrojnë informacione të paktën për kohëzgjatjen e procedimeve për këto katër çështje: divorce me palë kundërshtarë, heqje nga puna, grabitje, vrasje me dashje (siç përkufizohet në Shtojcën I).

Për të lehtësuar aplikimin e zgjidhjeve të përbashkëta në nivelin e Këshillit të Evropës, duhet të miratohet një metodologji standarde nga vetë vendet anëtare për llogaritjen e afateve të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Vendet anëtare duhet të jenë në gjendje të llogarisin të paktën këto tre raporte: normën e likuidimit të çështjeve, kohën deri në zbardhjen e vendimit dhe normën e efikasitetit, siç përkufizohet në Shtojcën I.

○ **Monitorimi i shkeljeve të nenit 6 të KEDNj-së**

Statistikat e përditësuara dhe të hollësishme të shteteve anëtare për çështjet e tyre që shkojnë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me të drejta të ndryshme që mbrohen nga neni 6 përbëjnë një mjet kyç për vlerësimin dhe menaxhimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, veçanërisht me qëllim zgjidhjen e situatave në shkelje të konventës. Organet përkatëse të shteteve anëtare ftohen të mbajnë statistika në formë tabelash për çështjet e tyre që lidhen me nenin 6 të KEDNj-së, në mënyrë që vendimet e Gjykatës të zbatohen si duhet dhe që shkeljet e mëtejshme të mund të parandalohen.

Këto tabela duhet të regjistrojnë në mënyrë të veçantë numrin e çështjeve të mëposhtme çdo vit:

- çështje të njoftuara nga gjykata
- çështje të shpallura të papranueshme nga Gjykata
- çështje që mbyllen me zgjidhje miqësore
- çështje që mbyllen me konstatim shkeljeje
- çështje që mbyllen pa konstatim shkeljeje

dhe që lidhen të paktën me:

- shkeljen e kërkesës për gjykim në një kohë të arsyeshme
- moszbatim të vendimeve të Gjykatës.



Këto tabela mund të mbulojnë sa më shumë që të jetë e mundur edhe të drejta të tjera që mbrohen nga neni 6 i KEDNj-së.

4. Konteksti dhe fushat e mbuluara gjatë misionit (JULINDA)

4.1. Reforma e gjyqësorit në Shqipëri

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri ka qenë objekt i transformimeve të vazhdueshme gjatë 30 viteve të fundit. Dispozitat e para kryesore kushtetuese demokratike janë miratuar në vitin 1991. Kushtetuta shqiptare e miratuar në vitin 1998 ka ndryshuar dhe ka përmirësuar më tej dispozitat për organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë, ndryshime që kanë pasur si qëllim rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies së sistemit. Pavarësisht kësaj, që prej vitit 1998, Kushtetuta është ndryshuar katër herë.²

Nga ana tjetër, Shqipëria ka nisur procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, një proces që kërkon konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe demokracisë. Shqipëria është njohur zyrtarisht nga Bashkimi Evropian (BE) si “vend i mundshëm kandidat” në vitin 2000; është miratuar dhe nënshkruar me sukses Marrëveshja e Stabilizim Asociimit më 12 qershor 2006 dhe që prej qershorit 2014, Republika e Shqipërisë është candidate zyrtare për aderimin në Bashkimin Evropian.

Dhënia e statusit të vendit kandidat ishte rrjedhojë e përpjekjeve të Shqipërisë për reforma në vitet e kaluara dhe njohje nga BE-ja e përpjekjeve të bëra dhe progresit të arritur në rrugën e integritimit të Shqipërisë. Megjithatë, hapja e negociatave varet nga reformat e mëtejshme konkrete dhe të qëndrueshme që do të ndërmarrë Shqipëria. Siç theksohet në Raportin e Progresit të vitit 2014 të Komisionit Evropian për Shqipërinë, vendi duhet t'i fokusojë përpjekjet e tij në zbatimin e reformave në fushat kryesore, sidomos në administratën publike dhe **reformën në drejtësi, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit**, si dhe forcimin e të drejtave themelore.

Në këto rrethana, ndryshimet e fundit kushtetuese në fushën e gjyqësorit janë miratuar nga Kuvendi Shqiptar në korrik të vitit 2016 (referuar si reforma në drejtësi në Shqipëri), me qëllim korrigjimin e mangësive që vinin për shkak të mungesës së koherencës së parashikimeve kushtetuese dhe atyre ligjore (sidomos pas ndryshimeve të vitit 2008), niveli i lartë i korrupsionit mes gjyqtarëve dhe prokurorëve, profesionalizmi i ulët i gjyqtarëve dhe prokurorëve, mungesa e mekanizmave eficientë të kontrollit ndaj tyre, mungesa e një ndarjeje të qartë të pushteteve mes organeve që rregullojnë sistemin e drejtësisë, si dhe ndikimi joproporcional i politikës tek drejtësia.

Ndryshimet kushtetuese të miratuara në korrik 2016 prekën rreth një të tretën e Kushtetutës dhe e ridizejuan thelbësisht sistemin shqiptar të drejtësisë. Pas këtyre ndryshimeve, u

² Ligji nr. 9675/2007, Ligji nr. 9904/2008, Ligji nr. 88/2012 dhe Ligji nr. 76/2016.



miratuan ose u ndryshuar 30 ligje të reja dhe ekzistuese, si dhe u futën në përdorim zgjidhje novatore që lidheshin me rivlerësimin (vetting-u) e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve aktualë.

Reforma e në drejtësi në Shqipëri u shoqërua me ndryshime thelbësore të sistemeve të drejtësisë dhe kompetencave të tyre përkatëse. Ndryshimet kyçe konsistojnë në ngritjen e organeve të reja qeverisëse të sistemit të drejtësisë, si: Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGj), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED). Kompetenca të ndryshme që më parë i përkisnin Ministrisë së Drejtësisë (MD), një prej aktorëve përfitues të projektit SEJ dhe SEJ II, u kanë kaluar këtyre institucioneve të reja. Si pjesë e reformës në drejtësi po mendohet edhe një hartë e re gjyqësore, e cila do të jetë kompetencë e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nga ana tjetër, Shkollës së Magjistraturës (ShM) i janë dhënë kompetenca të tjera, në lidhje me trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të magjistratëve, si dhe të kancelarëve të gjykatave, këshilltarëve ligjorë, ndihmësve ligjorë dhe punonjësve të tjerë të sistemit gjyqësor.

Institucionet e reja janë bërë funksionale vetëm së fundmi: KLGj-ja dhe KLP-ja janë ngritur në dhjetor të vitit 2018; edhe KED-ja, së cilës i është besuar zgjedhja paraprake e kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese dhe kandidatëve për pozicionin e ILD-së, filloi të funksionojë në fillim të vitit 2019 (ajo ka një mandat të përvitshëm, kështu që KED-ja 2020 sapo ka filluar aktivitetin); ndërsa ILD-ja është ngritur vetëm në janar të vitit 2020.

4.2. Kuadri Ligjor Vendas dhe Praktika për statistika gjyqësore në fushat e mbuluara gjatë misionit

○ Sistemi statistikor

Kuadri i ri ligjor deri në muajin korrik 2016 (Kushtetuta, nenet 147/a dhe 148/b) parashikojnë ngritjen dhe menaxhimin e strukturave të teknologjisë së informacionit për gjykatat dhe për prokuroritë me Vendim të Këshillit të Ministrave. Pjesë e këtij vendimi është edhe ngritja e Qendrës për Teknologjinë e Informacionit (QTI). QTI-ja ka për mision mbështetjen e sistemeve të ndryshme IT të institucioneve gjyqësore shqiptare, duke përfshirë Gjykatat, Prokuroritë, KLGJ-në, KLP-në, ILD-në, Arkivën Gjyqësore, etj. Për korrigjimin e mospërputhjeve dhe fragmentimit të praktikave të mëparshme për ruajtjen e të dhënave gjyqësore, KLGj-ja, si organ i ri kompetent, do të miratojë rregulla dhe udhëzime uniforme për menaxhimin e të dhënave gjyqësore në të ardhmen.

Ligji i ri “Për institucionet qeverisëse të sistemit të drejtësisë”³ i beson KLGj-së kompetencën e parashikimit të udhëzimeve për mbajtjen e statistikave gjyqësore dhe miratimin e rregullave standarde për punonjësit e gjykatave dhe për të gjithë përdoruesit e gjykatave në lidhje me monitorimin dhe shpërndarjen e të dhënave gjyqësore. KLGj-ja do të hartojë gjithashtu udhëzime për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe për marrjen e provave në gjykata.

³ Ligji nr.115/2016 “Për qeverisjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë” (neni 94).

Deri kohët e fundit, gjykatat i kanë mbledhur të dhënat statistikore gjyqësore në bazë të një metodologjie klasifikimi, e cila është krijuar dhe ruajtur në agjencinë kombëtare që merret me teknologjitë e informacionit (AKSHI). Kjo agjenci ka miratuar një tabelë përkufizimesh të përbashkëta për të gjitha gjykatat, e cila është zbatuar nga Ministria e Drejtësisë. Deri në ngritjen e KLGj-së, ishte Ministria e Drejtësisë ajo që mbikëqyrte shërbimin e unifikuar të statistikave në fushën e drejtësisë përmes Drejtorisë së saj për IT-në dhe Statistikat. Kjo do të thotë që krijimi i kategorive të reja të informacioneve në tabelat e përkufizimeve duhet të merrte miratimin e Ministrisë së Drejtësisë. Objektivat e sistemit ekzistues statistikor ishin kontrolli i gjyqësorit (sidomos sa i përket vlerësimit të gjyqtarëve) dhe jo monitorimi dhe vlerësimi i funksionimit të sistemit të gjykatave.

Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve (CMS) në Shqipëri është bazuar në sisteme të ndryshme IT: ARK-IT, ICMIS dhe CCMIS. Shumica e gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit operojnë me ICMIS; ARK-IT përdoret në Gjykatën e shkallës së parë të Tiranës dhe në Gjykatën e shkallës së parë të Krimeve të Rënda. CCMIS, paraardhësi i ICMIS-it, përdoret vetëm në Gjykatën e Lartë. Përveç përdorimit të disa sistemeve njëherësh, një sërë misionesh faktmbledhëse të CEPEJ, vizita dhe seminare, evidentuan mungesën e homogjenitetit në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për shkak se arkitektura e sistemit është e decentralizuar dhe jo e centralizuar: si rrjedhojë, gjykatat duken se përdorin metodologji të ndryshme për futjen dhe klasifikimin e çështjeve.

○ **Mbledhja e statistikave**

Sa i përket mbledhjes së statistikave, paketa e re legislative kërkon që gjykatat e të gjitha niveleve të përdorin metoda uniforme për mbledhjen e të dhënave, të njëjtat klasifikime çështjesh, tabela uniforme për përkufizimin e të dhënave, si dhe masa uniforme organizative nga ana e stafit të gjykatave. Intervali i mbledhjes së të dhënave përcaktohet sipas përdorimit të tyre, p.sh. çdo vit për të dhënat e mbledhura nga KLGj-ja, si dhe çdo tre muaj, dy herë në vit për të dhënat e mbledhura për nevojat e brendshme të gjykatave.

Nismat për standardizimin e të dhënave janë të nevojshme brendapërbrenda gjykatave dhe midis tyre dhe Kancelarët e Gjykatave janë në pozicion kyç për organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të tilla.

○ **Futja e të dhënave dhe validimi i tyre**

Futja e të dhënave është një element kyç për të pasur statistika të besueshme për gjykatat. Megjithatë, në shumicën e gjykatave, CMS-ja nuk përditësohet në mënyrë sistematike. Validimi i të dhënave, që është një detyrë kryesore me qëllim identifikimin e vlerës së të dhënave, që vjen nga një paketë e caktuar vlerash të pranueshme, bëhet me raste. Ndonëse sistemi elektronik zakonisht ofron disa funksionalitete për futjen e të dhënave për shmangien e gabimeve, në kontekstin e statistikave gjyqësore në Shqipëri ka nevojë për masa specifike.

○ **Publikimi i të dhënave dhe detyrimet për raportim**

Në varësi të natyrës së tyre, të dhënat gjyqësore mund të kualifikohen si të dhëna për përdorim publik ose të dhëna për përdorim të brendshëm të gjykatave/institucioneve.

Në nivel kombëtar, KLGj-ja ka përgjegjësinë të publikojë brenda muajit qershor të çdo viti një raport vjetor për ngarkesën e punës dhe numrin e çështjeve të gjykatave për vitin e mëparshëm kalendarik. Në nivel gjykatë, raportet mbi aktivitetin e gjykatave mund të publikohen në faqen zyrtare të internetit të gjykatave në mënyrë periodike (Të paktën një herë në vit), duke përfshirë rekomandime përkatëse, tabelat e statistikave të gjykatave, treguesit e performancës dhe grafikët. Ligji parashikon detyrime të tjera për raportim të brendshëm dhe raportim ndërkombëtar në lidhje me performancën e gjyqësorit që ka të bëjë me institucione të ndryshme të drejtësisë. Këto detyrime paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë.

Ofruesi(t) përgjegjës	Emri i Raportit	Qëllimi	Kujt i adresohet	Shpeshtës ia	Rregullore/udhëzi me/format i standardizuar
KLGj	Raport për ngarkesën e çështjeve dhe ngarkesën e punës së gjykatave	Vlerësimi i performancës së gjykatave	Publiku; Parlamenti	Raport vjetor	Jo
Ministria e Drejtësisë	Raport Statistikor Vjetor	Analiza e Sistemit të Drejtësisë	INSTAT/Publ iku në përgjithësi	Raport vjetor	Po – Udhëzimi nr. 4, datë 15/04/2019
Ministria e Drejtësisë	Vlerësimi i CEPEJ - Raporti në shkallë vendi	Vlerësimi i performancës së gjyqësorit	CEPEJ - KiE	Një herë në dy vjet	Jo
Ministria e Drejtësisë	Vlerësimi i Drejtësisë	Vlerësimi i performancës së gjyqësorit	CEPEJ - KiE	Çdo vit	Jo

Gjykatat/kryetarët	Raport për personelin e gjykatës dhe ngarkesën e çështjeve	Vlerësimi i performancës së gjykatës	KL Gj	Çdo tre muaj	Po – Vendim i KL Gj-së Nr. 25, datë 7/2/2019 “Për informimin periodik nga kryetarët e gjykatave për performancën e gjykatave”
Gjykatat/kancelarët	Raport për të gjitha kategoritë e çështjeve të gjykatave, ngarkesën e punës, afatet	Standardizimi i mbledhjes dhe përpunimit të statistikave. Për plotësimin e raportit vjetor statistikor të Ministrisë së Drejtësisë	Ministria e Drejtësisë	Çdo tre muaj	Po - Udhëzimi Nr. 4, datë 15/04/2019
Gjykatat	Statistikat e gjyqtarëve individualë	Vlerësimi i performancës	KL Gj – Komiteti për etikën dhe vlerësimin e performancës	Çdo vit	Po – Vendim i KL Gj-së nr. 264, datë 21/11/2019 Për miratimin e “Metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e shkallës së vlerësimit të gjyqtarëve” dhe Vendim i KL Gj-së nr. 60, datë 30/01/2020 Për miratimin e udhëzimeve

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

					orientuese “Për plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore me qëllim vlerësimin e etikës dhe profesionalizmit të gjyqtarëve”.
Gjykatat/Prokurorit ë	Raporte për çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar	Vlerësimi i historikut të çështjeve penale	Ministria e Drejtësisë	Çdo tre muaj	Po – Udhëzimi nr. 804/1, datë 23/12/2013 për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave për çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar

5. Misioni përgatitor për statistika gjyqësore të sistemit të drejtësisë në Shqipëri nga CEPEJ, janar 2017 (HAROLD)

Një mision i CEPEJ për statistikat gjyqësore u zhvillua në janar 2017 me qëllim identifikimin e masave për përmirësimin e mbledhjes dhe raportimit të statistikave gjyqësore në bazë të një “Raporti të thelluar vlerësimi të sistemit shqiptar të drejtësisë” dhe një ‘Raporti tematik për menaxhimin e kohës gjyqësore në gjykatat shqiptare’, të cilët janë publikuar dhe janë përgatitur paralelisht me aktorët përfitues të projektit në atë kohë.

Raportet e sipërpërmendura përfshinin rekomandime për adresimin më të mirë të sfidave ekzistuese për mbledhjen, menaxhimin dhe analizimin efikas të statistikave gjyqësore. Disa sesione të programeve të trajnimit të gjykatave, të zhvilluara në disa gjykata në Shqipëri, çuan në një njohje më të mirë të qasjes së përdorur nga CEPEJ sa i përket menaxhimit të gjykatave. Njohja e mjeteve dhe metodologjive të CEPEJ nga kryetarët e gjykatave dhe stafi i tyre u përmirësua, sidomos në lidhje me udhëzimet dhe treguesit e CEPEJ SATURN. Më pas, ekspertët ndërkombëtarë të CEPEJ dhe konsulentët vendas diskutuan mbi projekte që mund të realizohen për adresimin e çështjeve prioritare në gjykata për përmirësimin e punës së tyre të përditshme dhe statistikave gjyqësore.

Ato kishin si qëllim:



- përmirësimin e menaxhimit të kohës gjyqësore në gjykatat e përzgjedhura të të gjitha shkallëve; ne veçanti, ofrimin e ndihmës për përgatitjen e një analize së hollësishme të ngarkesës së çështjeve gjyqësore dhe ngarkesës së punës së secilës gjykatë, normës së likuidimit të çështjeve dhe kohës deri në zbardhjen e vendimit gjyqësor; rishikimin e zbatimit të Udhëzimeve të SATURN për menaxhimin e kohës gjyqësore në gjykata dhe ndihmën për përgatitjen e planeve të gjykatave për përmirësimin e menaxhimit të fluksit të çështjeve; në fund, për të dhënë kontribut, sipas rastit, në hartimin e raportit përfundimtar për eksperiencën në zbatimin e instrumenteve të SATURN në gjykata;
- ofrimin e kontributit për programin e trajnimit të trajnerëve për mjetet e SATURN dhe zbatimin e tyre nga gjykatat përfituese të projektit.
- analizimin dhe ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e procesit të mbledhjes së statistikave gjyqësore; si dhe dhënien e kontributit për trajnimin e stafit të institucioneve shqiptare përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave gjyqësore.

Si fillim, u përzgjedhën disa gjykata për të filluar përshtatjen e Udhëzimeve të CEPEJ SATURN sipas kontekstit shqiptar, bashkë me zgjerimin e Programit të Trajnimit të Gjykatave të CEPEJ për Udhëzimet e SATURN, duke përfshirë të gjitha gjykatat shqiptare.

Gjatë kohës së zhvillimit të aktiviteteve për përmbushjen e sa më sipër, u konstatua se disa rekomandime nuk janë zbatuar ende nga gjykatat. Veçanërisht ato që kanë të bëjnë me mbylljen e çështjeve në sistemin ICMIS, gjë që mbetet problem edhe sot, duke ndikuar drejtpërdrejt në saktësinë e raportimit të statistikave gjyqësore. U konstatua se stafi nuk i njih ende sa duhet mjetet dhe metodologjinë e CEPEJ, si dhe përdorimin e dashboard-eve të CEPEJ në atë kohë. U raportua se, pavarësisht se ekzistonte sistemi IT, gjykatat përdornin ende mbledhjen manuale të të gjitha të dhënave, të cilat i raportoheshin më pas Ministrisë së Drejtësisë, Zyrës së Statistikave, çdo tre muaj dhe çdo vit.

Si rrjedhojë, për të garantuar përmirësimin dhe rezultate konkrete në fushën e statistikave gjyqësore, SEJ II vendosi të fokusohet tek:

- Mbështetja për autoritetet gjyqësore dhe politikëbërësit me qëllim përmirësimin e statistikave gjyqësore përmes njohjes dhe të kuptuarit të mjeteve dhe metodologjisë së CEPEJ me sugjerime për masa që mund të merren për zbatimin e tyre konkret dhe efikas, sidomos me një metodologji konsistente për mbledhjen e statistikave gjyqësore, duke përdorur mjete IT (CMIS) që përmbajnë tregues të CEPEJ;
- Shumëfishimin e seancave trajnuese për organet përkatëse të përfshira në procesin e mbledhjes dhe analizimit të statistikave gjyqësore, duke rritur ndërgjegjësimin lidhur me udhëzimet GOJUST të CEPEJ dhe treguesit që përdoren për matjen dhe monitorimin e afateve dhe efikasitetit të gjyqësorit.

Në atë kontekst, misionet e vitit 2017 kishin raportuar ndërkohë disa gjetje interesante në lidhje me konsistencën e të dhënave të mbledhura:

- i) Përdorimin e metodologjive të ndryshme në klasifikimin ekzistues të të dhënave në gjykata;

- ii) Krahasimi me të dhënat e mbajtura në ICMIS tregonin se shumica e çështjeve të zgjidhura nuk ishin “mbyllur” në sistemin elektronik;
- iii) Në ICMIS, tabelat e përkufizimeve ndryshonin nga një gjykatë në tjetrën;
- iv) ICMIS nuk përmbante ndonjë raport statistikor identik me skedarin në Excel që kërkohej dhe prodhohej nga Ministra e Drejtësisë;
- v) Skedari në Excel nuk përmbante disa kontrole të automatizuara, të cilat rrisnin mundësinë e praktikave të ndryshme nga standardi;
- vi) Raportet përmbledhëse të përgatitura në shkallë kombëtare nuk ishin në asnjë lloj mënyrë të automatizuara dhe nuk mund të përdreshin gjithsesi për shkak të metodave të ndryshme të përdorura për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave.

Misioni i 2017-ës konfirmoi se statistikave bazoheshin në mbledhjen manuale të të dhënave në Regjistrat e gjykatave, të cilat i përcilleshin Departamentit të Statistikave në Ministrinë e Drejtësisë, por edhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ky i dyti nuk merrej me përpunimin e këtyre të dhënave. Këshilli i Lartë i Drejtësisë fokusohej vetëm tek informacionet disiplinore për gjyqtarët që mernte çdo muaj, si dhe tek informacioni që lidhej me vlerësimin e gjyqtarëve. Në lidhje me vlerësimin e gjyqtarëve, Këshilli i Lartë i Drejtësisë shprehte më vonë interesin për të marrë të dhëna më të hollësishme dhe më të besueshme mbi rastet që lidheshin me eficientësinë e gjyqtarëve të caktuar. Në këtë aspekt, rëndësia e opinionit të CCJE (Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë) për vlerësimin dhe transparencën e vlerësimit theksohej me idenë se edhe gjyqtarët duhet të kenë akses në këtë informacion që mund të përdoret për vlerësimin e performancës së tyre. Kjo çështje është trajtuar edhe gjatë misionit aktual të vitit 2020 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i Prokurorëve.

Vështirësitë që sjell përdorimi i mjeteve të ndryshme për menaxhimin e çështjeve në gjykatat e ndryshme shqiptare, kur vjen fjala tek raportimi i statistikave, janë përshkruar mjaft mirë edhe në misione të tjera të SEJII që janë fokusuar specifikisht tek IT-ja. Ndonëse janë identifikuar mënyra të ndryshme përmirësimi, është rënë dakord që do të duhej shumë kohë (dhe investime për një CMS të vetëm funksional) për të parë vërtet përmirësime të situatës. Ndërkohë, mbledhja manuale (pse gjysmë manuale) e të dhënave, pavarësisht shumëfishit të detyrave që kërkon, është parë dhe propozohet si zgjidhje e përkohshme, por efektive për problemin e mbledhjes së të dhënave statistikore dhe raportimin e tyre.

Ekspertët e misionit të vitit 2017 për statistika gjyqësore u shprehën:

*“Procesi i mbledhjes së të dhënave është **kryesisht manual**, në formularë në Excel që plotësohen nga gjykatat, mbi bazën e regjistrave fizikë ose në kombinim me ICMIS. Të dhënat e regjistruara në aplikacionet CCMIS me bazë web-in (Gjykata e Lartë) dhe ICMIS (të gjitha gjykatat e tjera) janë të përdorshme për çështjet e reja, por nuk ofrojnë informacione të besueshme për çështjet e zgjidhura. Kjo situatë vjen për shkak se janë vetëm gjyqtarët me akreditime të mjaftueshme në sistemin e menaxhimit të çështjeve që mund t'i “mbyllin” çështjet. Ndonjëherë, kredencialet e tyre u transferohen nëpunësve për ekzekutimin e këtij veprimi. EURALIUS ka theksuar se në procesin e futjes së të dhënave ka edhe probleme të tjera. Këto probleme që ulin cilësinë e të dhënave nuk janë komunikuar ende në gjykata për të mos i mbingarkuar me udhëzime të reja për përdorimin e ICMIS dhe për të mos i demotivuar.*”

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

Edhe pse ARK-IT është një aplikacion më i vjetër që funksionon në mënyrë të pavarur, ky sistem duket se është në gjendje të ofrojë informacione të besueshme për gjykatën e shkallës së parë të Tiranës me një trajtim manual minimal.

Kategorizimi i çështjeve për mbledhjen e të dhënave në shkallë kombëtare nuk duket se kuptohet nga gjykatat, sidomos nga gjykatat e apelit, edhe pse nevojat e drejtuesve të gjykatave janë të ndryshme nga nevojat e Ministrisë së Drejtësisë.

Agjencia kombëtare AKSHI ruan një kopje të bazës së të dhënave të gjykatave dhe mban tashmë një tabelë unike të përkufizimit të çështjeve që janë pastruar nga të dhënat e regjistruara më parë.

Për prokurorinë, sistemi i ri CAMS nuk është ende në gjendje të prodhojë për momentin tabela për statistika.

Konsolidimi i tabelave në Excel në Ministrinë e Drejtësisë nuk bëhet në mënyrë të automatizuar (as me komanda të thjeshta makro VBA) dhe kërkon shumë punë manuale.

Në përgjithësi, treguesit e CEPEJ (CR/DR/TB) nuk përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë në tabelat që prodhojnë sistemet IT dhe në tabelat e konsoliduara në Ministrinë e Drejtësisë. Që të gjithë bashkëbiseduesit që u takuan i njihnin mjaft mirë këto koncepte.”

Duke pasur parasysh këtë punë të mëparshme, ky mision kishte për detyrë të përditësonte praktikën e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave mes aktorëve të ndryshëm, si dhe të konfirmonte interesat dhe nevojat e institucioneve të sapokrijuara (KLGj, KLP, ILD) në lidhje me këto të dhëna për përmbushjen e rolit dhe përgjegjësi të tyre.

6. Vlerësimi dhe Rekomandimet e Ekspertëve (TË GJITHË EKSPERTET)

6.1. Bazat e mbledhjes së të dhënave dhe standardet

Konstatime: Nuk ekziston një koncept i përgjithshëm për gjenerimin e statistikave nga sistemi gjyqësor. Mungojnë gjërat bazë: p.sh. nuk ekziston i njëjti perceptim në nivel gjykatash për atë “çka quhet çështje”, si dhe nëse duhet të regjistrohen si çështje; nuk ka ndonjë rregullore të zbatuar apo të monitoruar/verifikuar nga ndonjë institucion qendror. Zgjidhjet në lidhje me qasjen që duhet të kenë për këto çështje u lihen në dorë gjykatave në mënyrë autonome, pa ndonjë koherencë apo uniformitet.

Rekomandim: Përmirësimi i bazës së mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë edhe përcaktimin e standardeve të njëjta

Masa që duhet të ndërmerren:

- Përcaktimi i përkufizimeve dhe standardeve të përbashkëta detyruese në lidhje me “çfarë përbën çështje gjyqësore”, kategoritë e çështjeve, metodologjitë e regjistrimit dhe



mbylles së çështjeve, të cilat duhet të përdoren në të gjitha gjykatat (mundësisht të përfshihen të gjitha në një rregullore të vetme apo diçka të ngjashme). KLGj-ja është sipas ligjit dhe praktikisht institucioni më i përshtatshëm për ta drejtuar këtë proces.

- Të merren masat për zbatimin si duhet të standardeve në gjykata përmes publikimit të dokumenteve të referencës (udhëzuesi për statistika gjyqësore), trajnimin e nëpunësve të gjykatave dhe kancelarëve.
- Rritja e ndërgjegjësimit për qëllimin dhe dobinë e mbledhjes së të dhënave dhe raportimeve statistikore në takimet periodike të kancelarëve të gjykatave dhe kryetarëve të gjykatave. Anëtarët e KLGj-së duhet të marrin pjesë në këto takime për të garantuar interpretimet dhe zgjidhjet uniforme sa herë që dalin probleme.
- Përkufizimi i qartë i përgjegjësive dhe detyrave specifike që lidhen me monitorimin e mbledhjes së të dhënave dhe kontrollit të cilësisë në nivel gjykatë, si dhe në nivelin e KLGj-së përmes një akti nënligjor (p.sh. përmes një akti normativ të Këshillit). Ngritja e një mekanizmi monitorimi për këtë qëllim.
- Hartimi dhe miratimi i mekanizmave të kontrollit të cilësisë – brendapërbrenda dhe/ose si një mision i ekspertëve të CEPEJ – me qëllim garantimin e respektimit të standardeve.

6.2. Statistikat strategjike

Konstatime: Të dhënat mblihen sipas qëllimit, por nuk ka një strategji të përgjithshme vjetore. Gjykatat dhe departamentet statistikore janë të mbingarkuara dhe nuk e kanë të qartë qëllimin e përgjithshëm të mbledhjes së të dhënave.

Rekomandim: KLGj-ja duhet të hartojë një strategji për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin për të ulur ngarkesën e departamenteve statistikore në nivel gjykatë, të garantojë koherencën mes tyre dhe të shmangë mbivendosjet. Megjithatë, kjo strategji duhet të garantojë mbledhjen e informacioneve të nevojshme që do të mundësonin masat e bazuara në prova me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së gjyqësorit.

Masat që duhet të ndërmerren:

- Përcaktimi i një harte të detyrimeve/kërkesave për raportim që janë pjesë e gjykatave, qoftë përmes KLGj-së, institucioneve të tjera apo vetë gjykatave.
- Shtjellimi i një vizioni të qartë për të dhëna statistikore të standardizuara që nevojiten për menaxhimin e gjykatave dhe të sistemit gjyqësor.
- Verifikimi i raporteve statistikore të tepërta dhe ndalimi i tyre.
- Përgatitja e një plani vjetor për gjykatat, duke specifikuar çfarë të dhënash duhet të mbledhin dhe kur (d.m.th. në ç'periudhë të vitit) jo çdo gjë nga 1 janari dhe sa shpesh duhet të mblihen): “pak e saktë”.
- Hartimi i formateve të standardizuara për raportimet statistikore për gjykatat (të cilat duhet të përdoren në të gjitha gjykatat) dhe për Këshillin.

6.3. Menaxhimi gjyqësor objektiv

Konstatime: Duke qenë se cilësia e të dhënave është mjaft e ulët, menaxhimi objektiv përmes fakteve dhe shifrave, së bashku me përgjegjësitë zyrtare, është i vështirë ose joekzistent. Momenti i ngritjes së institucioneve të reja (KLGj, KLP dhe ILD) jep mundësinë për të qartësuar gjërat dhe për t'i rifokusuar ato në aspektet që kanë vërtet rëndësi. KLGj-ja e sapongritur në mënyrë të veçantë ka zhvilluar një vizion të qartë për misionin e saj dhe ka filluar të trajtojë vështirësitë e dukshme (cilësinë e të dhënave, zhvillimin e raporteve statistikore të standardizuara). Për këtë fushë kanë shprehur interes edhe KLP-ja dhe ILD-ja.

Rekomandim: Përmirësimi i menaxhimit gjyqësor objektiv përmes përdorimit të vullit të institucioneve të sapongritura, sidomos KLGj-së së motivuar dhe vizionare.

Asistimi i KLP-së dhe ILD-së në përcaktimin e nevojave të tyre në fushën e statistikave gjyqësore, në mënyrë që ato t'i kryejnë më mirë detyrat e tyre.

Masat që duhet të ndërmerren:

- KLGj-ja duhet të përcaktojë nevojat dhe të ndajë përgjegjësitë në sistemin gjyqësor, nga gjykata e sipër, në bazë të provave të besueshme (fakte dhe shifra).
- KLGj-ja duhet të ngrëjë mekanizma për përmbushjen efikase të këtyre përgjegjëseve.
- Hartimi i raporteve statistikore të qarta, praktike dhe të standardizuara dhe vënia e tyre në dispozicion të Kryetarëve të Gjykatave, Drejtuesve të Prokurorive dhe Kancelarëve për përmbushjen e përgjegjëseve të tyre.
- Përcaktimi i kuadrit për statistikave gjyqësore për adresimin e nevojave të institucioneve të sapokrijuara (KLP dhe ILD)

6.4. IT

Konstatime: Aktualisht ekzistojnë deri në 37 zgjidhje individuale për mbledhjen e të dhënave, financuar nga donatorë dhe projekte të ndryshme. Asnjë prej këtyre zgjidhjeve pilote nuk është zbatuar në shkallë vendi. Kjo çon në një sistem të kushtueshëm dhe joeficient të mbledhjes së të dhënave.

Rekomandim: Adresimi dhe korrigjimi urgjent i problemit të sistemit tejet të fragmentuar të mbledhjes së të dhënave përmes vlerësimit të zgjidhjeve ekzistuese dhe identifikimit të zgjidhjeve më të mira (duke përfshirë edhe sa i përket kursimit të kostove dhe lehtësisë në përdorim).

Ndërkohë, rekomandohet krijimi i një kulture të përbashkët dhe krijimi i një procesi cilësor në fushën e statistikave gjyqësore të bazuara në mbledhjen dhe raportimin manual (duke përdorur të gjitha burimet që mund të ofrojë një program si MS Excel), gjë që do të ndihmojë për të kursyer kohë në momentin që një zgjidhje e re dhe e vetme CMS vihet në funksionim, me qëllim eliminimin përfundimisht të dublimit të detyrave.

Masat që duhet të ndërmerren:



- Të merren menjëherë vendime dhe masa për unifikimin e mbështetjes IT për mbledhjen e të dhënave/statistikave/menaxhimin gjyqësor.
- Të zbatohen këto vendime së bashku me përgjegjësitë politike/gjyqësore.
- Të fillojë aplikimi i një kulture të përbashkët sa i përket cilësisë në fushën e statistikave gjyqësore pa vonesë, bazuar në praktikën aktuale manuale (ose me ndihmën e excel-it).

6.5. Politika

Konstatime: Në përgjithësi, 20 vjet pas një mbështetjeje të konsiderueshme ndërkombëtare, ka ende një “kërkesë të madhe për mbështetje”, pa përdorur fillimisht kapacitetet e brendshme për zgjidhje (“*Junkie Paradox*”). Pavarësisht përpjekjeve të kohëve të fundit, vazhdon të jepet mbështetje pa ndonjë koordinim të madh mes Donatorëve në praktikë, duke krijuar zgjidhje të kushtueshme në trajtën e ishujve të veçuar nga njëri-tjetri.

Rekomandim: Rritja e ndërgjegjësimit dhe ndërtimi i kapaciteteve për t’i dhënë mundësi institucioneve të operojnë në mënyrë autonome në fushën e mbledhjes së të dhënave dhe statistikave, me qëllim eficientë dhe funksionimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme.

Masat që duhet të ndërmerren:

- Krijimi i trajnimeve të përshtatura për institucionet dhe personelin e tyre me qëllim:
 - rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e qasjeve të qëndrueshme,
 - shfrytëzimi i burimeve të vetë institucioneve
 - eksplorimi i mundësive për mbulimin e kostove përtej donacioneve të donatorëve.
- Garantimi i një koordinimi efikas mes donatorëve në praktikë dhe konsulencave të autoriteteve lokale me një qëndrim përzgjedhës sa i përket zgjedhjes së projekteve që duhet të zbatohen (garantimi i koherencës dhe shmangia e zbatimit të projekteve për zgjidhjen e problemeve të veçuara, qoftë edhe duke marrë përsipër koston e mospranimit të projekteve të propozuara).

6.6 Të ndryshme

Konstatime: Ndonëse pozicioni i Inspektorit të Lartë Gjyqësor është i përkufizuar mirë me ligj, mënyra se si duhet të organizohet ky shërbim dhe instrumentet apo proceset në dispozicion të tij për kryerjen e detyrës janë ende në proces hartimi.

Rekomandim: Përfshirja e Inspektorit të Lartë Gjyqësor në një dialog mes palëve për shkëmbimin e modeleve organizative dhe praktikave më të mira me një numër të zgjedhur përfaqësuesish nga shërbimet e Inspektoratit të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

Masat që duhet të ndërmerren:

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

- Organizimi i një seminari ndërkombëtar me përfaqësues të shërbimeve të Inspektorateve për diskutimin e disa çështjeve organizative në bazë të prioriteteve të Inspektorit të Lartë Gjyqësor.

7. Lista e rekomandimeve

Rekomandime	Masa
<p>Mbledhja e të dhënave dhe standardet Përmirësimi i aspekteve bazë të mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë edhe vendosjen e standardeve të njëjta</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● Përcaktimi i përkufizimeve dhe standardeve të njëjta të detyrueshme për “çfarë quhet çështje”, kategoritë e çështjeve, metodologjinë e regjistrimit, të cilat duhet të përdoren në të gjitha gjykatat (mundësisht të përfshihen në një rregullore të vetme apo diçka të ngjashme). KLGj-ja është sipas ligjit dhe në praktikë institucioni më i përshtatshëm për drejtimin e këtij procesi. ● Marrja e masave për zbatimin si duhet të standardeve në gjykata përmes trajnimit të nëpunësve dhe kancelarëve të gjykatave ● Rritja e ndërgjegjësimit për qëllimin dhe dobinë e mbledhjes së të dhënave dhe raporteve statistikore në takimet periodike të kancelarëve të gjykatave dhe kryetarëve të gjykatave. Anëtarët e KLGj-së duhet të marrin pjesë në këto takime për të garantuar interpretimin dhe zgjidhjet uniforme ku ngrihen probleme. ● Krimi dhe zbatimi i rregullave për zbatimin e këtij standardi. ● Përcaktimi i përgjegjësive të qarta dhe detyrave specifike në lidhje me monitorimin e procesit të mbledhjes së të dhënave dhe kontrollit të cilësisë në nivel gjykatë, si dhe në nivelin e KLGj-së me akte nënligjore (p.sh. përmes një akti normativ nënligjor të Këshillit). ● Ngritja dhe miratimi i mekanizmave të kontrollit të cilësisë me qëllim garantimin e respektimit të standardeve.

<p>Statistika strategjike KLGj-ja duhet të hartojë një strategji për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin për të ulur ngarkesën e departamenteve statistikore në nivel gjykatave, të garantojë koherencën mes tyre dhe të shmangë mbivendosjet. Megjithatë, kjo strategji duhet të garantojë mbledhjen e informacioneve të nevojshme që do të mundësonin masat e bazuara në prova me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së gjyqësorit.</p>	<ul style="list-style-type: none">● Përcaktimi i një harte të detyrimeve/kërkesave për raportim që janë pjesë e gjykatave, qoftë përmes KLGj-së, ose institucioneve të tjera apo vetë gjykatave.● Shtjellimi i një vizioni të qartë për të dhëna statistikore të standardizuara që nevojiten për menaxhimin e gjykatave dhe sistemit gjyqësor.● Verifikimi i raporteve statistikore të tepërta dhe ndalimi i tyre.● Përgatitja e një plani vjetor për gjykatat, duke specifikuar çfarë të dhënash duhet të mbledhin dhe kur (d.m.th. në ç'periudhë të vitit) jo çdo gjë nga 1 janari) dhe sa shpesh duhet të mblidhen): “sa më pak, aq më mirë”.● Hartimi i formateve të standardizuara për raportimet statistikore të gjykatave (Të cilat duhet të përdoren në të gjitha gjykatat) dhe për Këshillin.
<p>Menaxhimi gjyqësor objektiv Përmirësimi i menaxhimit gjyqësor objektiv përmes përdorimit të momentit të institucioneve të sapo ngritura, sidomos KLGj-së së motivuar dhe vizionare.</p> <p>Asistimi i KLP-së dhe ILD-së në përcaktimin e nevojave të tyre në fushën e statistikave gjyqësore, në mënyrë që ato t'i kryejnë më mirë detyrat e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none">● KLGj-ja duhet të përcaktojë nevojat dhe të ndajë përgjegjësitë në sistemin gjyqësor, nga gjykata e sipër, në bazë të provave të besueshme (fakte dhe shifra).● KLGj-ja duhet të ngrëjë mekanizma për përmbushjen efikase të këtyre përgjegjësi.● Hartimi i raporteve statistikore të qarta, praktike dhe të standardizuara dhe vënia e tyre në dispozicion të Kryetarëve të Gjykatave, Drejtuesve të Prokurorive dhe Kancelarëve për përmbushjen e përgjegjësi të tyre.● Përcaktimi i kuadrit për statistikave gjyqësore për adresimin e nevojave të institucioneve të sapo krijuara (KLP dhe ILD)

Teknologjia e Informacionit Adresimi dhe korrigjimi urgjent i problemit të sistemit tejet të fragmentuar të mbledhjes së të dhënave përmes vlerësimit të zgjidhjeve ekzistuese dhe identifikimit të zgjidhjeve më të mira (duke përfshirë edhe sa i përket kursimit të kostove dhe lehtësisë në përdorim.

Ndërkohë, rekomandohet krijimi i një kulture të përbashkët dhe krijimi i një procesi cilësor në fushën e statistikave gjyqësore të bazuara në mbledhjen dhe raportimin manual (duke përdorur të gjitha burimet që mund të ofrojë një program si MS Excel), gjë që do të ndihmojë për të kursyer kohë në momentin që një zgjidhje e re dhe e vetme CMS vihet në funksionim, me qëllim eliminimin përfundimisht të dublimit të detyrave.

- Të merren menjëherë vendime dhe masa për unifikimin e mbështetjes IT për mbledhjen e të dhënave/statistikat/menaxhimin gjyqësor.
- Të zbatohen këto vendime së bashku me përgjegjësitë politike/gjyqësore.
- Të fillojë aplikimi i një kulture të përbashkët sa i përket cilësisë në fushën e statistikave gjyqësore pa vonesë, bazuar në praktikën aktuale manuale (ose me ndihmën e excel-it).

Politika Rritja e ndërgjegjësimit dhe ndërtimi i kapaciteteve për t'i dhënë mundësi institucioneve të operojnë në mënyrë autonome në fushën e mbledhjes së të dhënave dhe statistikave, me qëllim efencen dhe funksionimin në mënyrë të qëndrueshme.

- Krijimi i trajnimeve të përshtatura për institucionet dhe personelin e tyre me qëllim:
 - rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e qasjeve të qëndrueshme,
 - shfrytëzimi i burimeve të veta
 - eksplorimi i mundësive për mbulimin e kostove përtej donacioneve të donatorëve.
- Garantimi i një koordinimi efikas mes donatorëve në praktikë dhe konsulencave të autoriteteve lokale me një qëndrim përzgjedhës sa i përket zgjedhjes së projekteve që duhet të zbatohen (garantimi i koherencës dhe shmangia e zbatimit të projekteve për zgjidhjen e problemeve të veçuara, qoftë edhe duke marrë përsipër koston e mospranimit të projekteve të propozuara).

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

Të ndryshme Përfshirja e Inspektorit të Lartë Gjyqësor në një dialog mes palëve për shkëmbimin e modeleve organizative dhe praktikave më të mira me një numër të zgjedhur përfaqësuesish nga shërbimet e Inspektoratit të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

- Organizimi i një seminari ndërkombëtar me përfaqësues të shërbimeve të Inspektorateve për diskutimin e disa çështjeve organizative në bazë të prioriteteve të Inspektorit të Lartë Gjyqësor.